



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 872/ Prot.
sp

Tiranë, më 10.10 2023

VENDIM

Nr. 38 datë 09.10.2023

“Për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar Pedagogjik-Psikologjik, në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2023-2024”

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, neni 81, pika 1, 2 dhe 3, neni 109; dhe Statutin e Universitetit të Tiranës neni 7, si dhe në propozimin e bazuar në Urdhrin e Brendshëm nr. 20, datë 04.07.2022, “Për ngritjen e Grupit të Punës me ekspertizë në fushën e pedagogji-psikologjisë për formimin e lektorëve të rinj në Universitetin e Tiranës” dhe Urdhrin e Brendshëm nr. 20/1, datë 29.09.2022 “Për një shtesë në Urdhrin e Brendshëm nr. 20, datë 04.07.2022, “Për ngritjen e Grupit të Punës me ekspertizë në fushën e pedagogji-psikologjisë për formimin e lektorëve të rinj në Universitetin e Tiranës” të Rektorit të Universitetit të Tiranës, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 09.10.2023;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar Pedagogjik-Psikologjik në Universitetin e Tiranës sipas dokumentacionit bashkëngjitur, për vitin akademik 2023-2024.
2. Të miratojë formën e certifikatës për programin e studimit të formimit të vazhduar Pedagogjik-Psikologjik në Universitetin e Tiranës.
3. Dokumentacioni përkatës të përcillet për miratim në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
4. Dokumentacioni përkatës të përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së certifikatës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Artan Hoxha

